

MARREVESHJE
E BASHKIMIT ME PERTHITHJE

Ne Tirane sot me 31.03.2023, lidhet kjo marreveshje midis:

Shoqerise Tregtare "DOPPLER-AL" SHPK, me seli ne Tirane, Berxull Autostrada Tirane-Durres, km 12 (rruga dytesore), godina 2-kateshe nr 6, eshte regjistruar si person juridik me date 12.10.2010, prane Qendres Kombetare te Biznesit (Q.K.B), me numer identifikimi NIPT-i L02212005G, e perfaqesuar nga Z. Xhili MESTANI, shtetas shqiptar, madhor e me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, ne cilesine e perfaqesuesit te Shoqerise **(Shoqeria perthithese/Doppler-Al shpk)**

dhe

Shoqerise Tregtare "LORJON" SHPK, me seli ne Tirane, Berxull Autostrada Tirane-Durres, km 12 (rruga dytesore), godina 2-kateshe nr 6, eshte regjistruar si person juridik me date 11.07.2011, prane Qendres Kombetare te Biznesit (Q.K.B), me numer identifikimi NIPT-i L11911005V, e perfaqesuar nga Z. Xhili MESTANI, shtetas shqiptar, madhor e me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, ne cilesine e perfaqesuesit te Shoqerise **(Shoqeria e perthithur/Lorjon shpk)**

Ketu dhe me poshte Shoqeria Perthithese dhe Shoqeria e perthithur do te referohen bashkarisht si "**Palet**".

Neni 1

Objekti

Objekt i kesaj marreveshje bashkimi me perthithje, eshte perfundimi i procedurave ligjore per bashkimin me perthithje te shoqerive "Doppler-al" shpk ne cilesine e shoqerise perthithese, dhe shoqerise "Lorjon" shpk ne cilesine e shoqerise se perthithur, nepermjet kalimit te te gjitha aktiveve dhe pasiveve (detyrime + kapital) ne favor te shoqerise perthithese, sic ato rezultojne deri ne daten e realizimit te perthithjes.

Neni 2

Baza ligjore

1. Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "per tregtare dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, neni 215-225.
2. Ligji nr.9723, date 03.05.2007 "Per rregjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Neni 3

Qellimi i Motivimit

Shkurtimi i shpenzimeve dhe rritja e mireadministrimit, nisur nga fakti qe te dyja shoqerite tregtare "LORJON" SHPK Tirane, dhe "DOPPLER-AL" SHPK Tirane, qe marrin pjese ne kete marreveshje, kane te njejtin Ortak dhe Administrator te perbashket, si dhe jane pale te lidhura pase njera pale eshte qeramarese dhe tjetra qeradhenese, bashkimi i ketyre dy shoqerive tregtare me perthithje do te krijojte premisa per nje menaxhim me te mire dhe rezultativ te aktivitetit ekonomik.



Neni 4

Qellimi i Motivimit

1. Bashkimi me perthithje te shoqerive "Doppler-al" shpk ne cilesine e shoqerise perthithese dhe "Lorjon" shpk ne cilesine e shoqerise se perthithur, eshte nje veprim juridik me te cilin shoqeria e perthithur transferon te gjitha aktivet dhe pasivee saj (detyrime + kapital) te cilat jane pasqyruar e pasqyrat financiare te shoqerise, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi deri ne momentin e perthithjes, tek shoqeria perthithese, duke pushuar se ekzistuari ne kete menyre shoqeria e perthithur, pa kaluar ne likuidim.
2. Palet ne kete marreveshje shprehin vullnetin e tyre per pranimin e ketyre procedurave dhe pasojave te tyre.

Neni 5

Raporti i Kuotave

1. Kapitali aksionar ne Shoqerine e krijuar mbas perthithjes do te jete 6.490.000 (Gjashte milion e katerqind e nentdhjete mije) Leke e barabartë kjo me 6.490 (gjashtemije e katerqind e nentdhjete) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 1,000 (nje mije) Lekë, i zoteruar 100 % nga Ortaku i Vetem z. Xhili Mestani;

Neni 6

Organet Administrative, punemarresit

1. Ne perfundim te procedures se bashkimit te shoqerive me perthithje, Organi Administrativ i shoqerise do te vijojte te drejtohet nga administratoret e shoqerise perthithese, respektivisht z. Xhili MESTANI, dhe z. Fatmir MUKA sipas afateve dhe kompetencave qe kane aktualisht, me te njejtat te drejta sic jane percaktuar ne statutin e shoqerise perthithese .
2. Statuti dhe Akt themelimi do te mbeten ata te shoqerise "Doppler-Al" shpk perpara bashkimit me perthithje.
3. Punemarresit e shoqerise se perthithur, do te konsiderohen si punemarres se shoqerise perthithese, dhe do te gzojne te gjitha te drejtat dhe detyrimet sipas Kodis se Punes, duke u transferuar tek shoqeria perthithese me te gjitha te drejtat dhe detyrimet perkatese.

Neni 7

Garancite per kreditoret dhe mbrojtja e tyre

1. Ceshtja Themelore e kesaj procedure bashkimi me perthithje e shoqerive eshte garantimi i kreditoreve te shoqerive te perfshira ne kete bashkim, sidomos ata te shoqerise se perthithur ne kushtet kur pamvaresisht humbjes se debitorit fillestar (shoqerise se perthithur), detyrimet e tyre i transferohen sipas ligjit ne teresi dhe te pacenuara shoqerise perthithese ashtu sic jane bere te njohura deri ne momentin e perthithjes.
2. Shoqeria Perthithese (Doppler-al) merr persiper sipas ligjit te behet pasardhese e shoqerise se perthithur ne marredheniet me te tretet, kundrejt te gjitha kreditoreve dhe debitorëve te shoqerise se perthithur (Lorjon), duke garantuar kreditoret e shoqerise se perthithur qe mund ti kundrejtojne te gjitha pretendimet e tyre, te rezultuara deri ne momentin e perthithjes ndaj shoqerise perthithese.

Neni 8

Prishja pa likujdim e shoqerise se perthithur.

1. Shoqeria e perthithur (Lorjon) si shoqeri e perthithur nga shoqeria Doppler-Al shpk, ne perfundim te ketij procesi do te vleresohet e prishur pa likujdim, duke kaluar plotesisht trashegimine e saj ekonomike, financiare dhe ligjore tek shoqeria perthithese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit, duke u c'regjistruar nga rregjistrimi kombetar i Qendres Kombetare te Biznesit, pa kaluar ne procesin e likujdimit.

Neni 9

Mbyllja

Ne daten e mbylljes se bashkimit me perthithje palet do te dorezojne prane QKB-se, krahas kesaj marreveshje dhe:

- Vendimet e Ortakeve te Shoqerise Perthithese dhe Shoqerise se Perthithur
- Kerkesen e Administratoreve te shoqerive per rregjistrimin dhe realizimin e kesaj procedure bashkimi me perthithje.

Neni 10

Te tjera

1. Kjo marreveshje (bashke me dokumentat te cilat ajo referon) perben marreveshjen ne teresi te paleve, duke zevendesuar dhe pasur perparesi nga cdo marreveshje te meperparshme midis paleve lidhur me kete ceshtje.
2. Cdo ndryshim i saj eshte i vlefshem vetem neqoftese realizohet me shkrim dhe miratohet nga palet.
3. Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim midis paleve. Nese nuk arrihet marreveshje mirekuptimi, organi kompetent per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo marreveshje hartohet ne gjuhen shqipe, ne tre kopje ekzemplare origjinale, dhe seicila prej paleve i nenshkruan rregullisht me vullnetin e tyre te lire.

PALET

Per Shoqerine
"LORJON" SHPK
Xhili MESTANI



Per Shoqerine
"DOPPLER-AL" SHPK
Xhili MESTANI

